

VENDIM
Nr.14, datë 11.3.2005

PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE,
NGA SHOQËRIA “SPAHIU – GJANÇ” SHPK

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa b, dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike ”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.3.2005, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “SPAHIU–GJANÇ” sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për HEC-in Gjanç dhe relacionin e përgatitur nga Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve, mbi bazën e një analize të hollësishme të kostos,

VENDOSI :

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria “SPAHIU- GJANÇ” sh.p.k., për HEC-in Gjanç, për periudhën 1.1.2005-31.12.2005, të jetë 5,9 lekë/kWh.
 2. Ngarkohet shoqëria “SPAHIU–GJANÇ” sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema